



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 15.06.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion.

ZNJ. E _____ S. _____
"CITY NEWS ALBANIA"
Të dhënat e kontaktit:

E nderuar znj. S

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, dërguar në datë 3.6.2022 dhe protokolluar me tonën nr. 2200 prot., datë 3.6.2022, dëshirojmë t'ju sqarojmë se:

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit zbaton me rigorozitet Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe të gjithë kuadrin ligjor në fuqi. Për çdo subjekt rivlerësimi që i nënshtrohet hetimit administrativ në KPK, anëtarët e Komisionit, por edhe vet subjekti i rivlerësimit bazuar në detyrimet që rrjedhin nga ligji, deklarojnë dhe nënshkruajnë mungesën e konfliktit të interesit, kjo me qëllim zbatimin e ligjit, si dhe garantimin e një procesi rivlerësimi të drejtë e të pavarur ligjor.

Sa më sipër, ju informojmë se anëtarja e Komisionit, znj. F _____ Sh _____ nuk është pjesë e trupës gjyquese që po heton dosjen e subjektit M _____ Z _____

Publiku dhe ju si media, do të njiheni më përbërjen e trupit gjykues për këtë subjekt kur Komisioni i Pavarur i Kualifikimit të njoftojë në faqen e tij zyrtare, datën për seancën dëgjimore, si dhe, në vendimin e arsyetuar me shkrim pas shpalljes së vendimit përfundimtar.

Ju urojmë punë të mbarë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

